



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1040/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.P “Termokos” Sh.A., me numër unik identifikues 810514829 dhe seli në Prishtinë, rr. “28 Nëntori”, nr. 181, Dardani, kundër debitorit “Dukagjini Invest” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr.”Bill Klinton”, Dukagjini Residence, lam.B, kati 4, nr. 4b, Lakrishtë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 902/23, i lejuar më datë 19.06.2023, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 02.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Dukagjini Invest” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 902/23, i lejuar më datë 19.06.2023, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “Termokos” Sh.A., Kartelës së kontabilitetit me shifër 016912 të lëshuar nga kreditori, ka lejuar urdhrin për përmbarim P.nr. 902/23, të datës 19.06.2023, me të cilin është urdhëruar debitori Dukagjini Invest Sh.P.K., që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 746.49, me kamatëvonesë prej 8% në vit duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme për pagesë, përkatësisht nga datat sipas faturave e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, me arsyetimin se borxhi i kërkuar nga kreditori është i parashkruar konform dispozitave ligjore të LMD-së. Më tej, ka theksuar se propozimi për përmbarim është i mangët dhe nuk i plotëson kushtet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, sepse nuk është cekur se për cilën faturë bëhet fjalë dhe as numri i faturës, duke shtuar edhe faktin se njësitë banesore janë shitur nga ana e debitorit dhe se ky borxh nuk duhet t'i ngarkohet të njëjtit. Për këto arsye, Gjykatës, i ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Në përgjigje në prapësim, kreditori ka theksuar se prapësimi i debitorit është parashtruar me qëllim të prolongimit të procedurës. Ka shtuar, se pretendimi sa i përket parashkrimit nuk qëndron për faktin se mbetja e borxhit për periudhën 10.2020 deri më 04.2022 është në shumë prej 746.49€, deri sa nuk është dorëzuar propozimi për përmbarim, kurse prej periudhës 01.2022 deri më 04.2022 është shuma prej 238.97€. Më tej, ka theksuar se dokumenti siç është libri i shitjeve përmban të gjitha elementet që duhet të përmbajë një dokument i besueshëm duke u bazuar në nenin 27, pika 1 si dhe në nenin 29, pika 1.2 dhe 3 të LPP-së. Sa i përket pretendimit që njësitë banesore nuk i takojnë më debitorit, i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për ndërrimin e emrit por ka vazhduar që t'i pranojë shërbimet e ngrohjes. Në fund, Gjykatës, i ka propozuar të refuzohet prapësimi i debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigjes në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1, i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në pikën 1.2 të po këtij nen, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Tutje, paragrafi 3 i nenit 29 të LPP-së, përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, në anën tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së, *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm,*

mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit".

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e cekura si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht kartela e kontabilitetit me shifër 16912, mbi bazën e së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Me nenin 29, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, është përcaktuar në mënyrë taksative se për cilat shërbime ekstraktet e verifikuara nga librat afariste përbëjnë dokument të besueshme. Ndërsa, duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbarim është lejuar mbi bazën e kartelës së kontabilitetit në emër të shërbimeve të ngrohjes të ofruara nga kreditori N.P "Termokos" Sh.A., gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Meqenëse dokumenti, kartela e kontabilitetit mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, nuk paraqet dokument të besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk lëshua fare në pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1040/23, datë 02.11.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.